VENDIM
Nr.35, datë 20. 5.2010

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.68, DATË 20.2.2003 "PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT TË DEPUTETËVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 "Për statusin e deputetit", të ndryshuar, si dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e sekretariateve për statusin e deputetit dhe për buxhetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr.68, datë 20.2.2003 "Për mënyrën e trajtimit të deputetëve", të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

I. Në pikën 1, fjalia e dytë zëvendësohet me fjalitë e mëposhtme:

"Raportet e përbërësve të pagës mujore të deputetit janë si më poshtë:

a) 40 % të pagës për pjesëmarrjen në seancë plenare;

b) 50 % të pagës për pjesëmarrje në mbledhjet e komisioneve të Kuvendit,

c) 10 % të pagës për pjesëmarrje në veprimtari të tjera parlamentare.

Mospjesëmarrja e deputetit në mbledhjet e komisioneve të përhershme të Kuvendit apo seancë plenare passjell ndalesën e pjesshme të pagës, sipas shkronjave "a" dhe "b", në përputhje me frekuentimin e tij në to për një muaj. Në rastet e moszhvillimit të mbledhjes së komisionit, për shkak të mungesës së kuorumit, deputetët e pranishëm përjashtohen nga ndalesa e pagës për këtë mbledhje.".

II. Pas pikës IV shtohet pika V me këtë përmbajtje:

"V. Raportet e pagës, të parashikuara në pikën 1 të vendimit, zbatohen edhe për përfitimet e tjera që ka deputeti, si: dieta, shpenzime transporti, shërbime telefonike apo shpenzime për strehimin, të cilat i paguhen deputetit përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e tij në mbledhjet e komisioneve të përhershme apo seancë plenare.".

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)